

## Praktika Mësimore

Kodi i lëndës	Semestr i	Kreditet e lëndës				Kredit e
		Leksione	Ushtrime/ Seminare	Laboratore	Praktikë mësimore	
B-ELN-350	VI	-	-	-	4	4
<b>Sasia e orëve: auditor/ jashtë auditorit</b>		-	-	-	92/8	92/8
<b>Sasia e orëve: Total</b>		-	-	-	100	100

### Objektivat e lëndës

Praktika mësimore ka për qëllim të ofrojë, për studentet para diplomimit, marrjen e njohurive në mjedisin e punës, duke punuar me një specialist të kualifikuar të fushës, për të rritur efektivitetin e përfitimit të njohurive praktike. Praktika synon të nxitë motivimin për profesionin e inxhinierit, të nxitë bashkëpunimin me grupet e specialistëve të fushave respektive, të ndihmojë në zhvillimin e aftësive profesionale dhe nga ana tjetër, ti japë studentit mundësinë të përgatitë një diplomë origjinale, të konkretizuar. Praktika krijon një mundësi për t'u punësuar në të ardhmen, në vendet e mundshme të lira, pranë kompanive institucioneve, organizatave respektive.

### Njohuritë dhe aftësitë që përfitohen nga përvetësimi i praktikës mësimore

Praktika zhvillohet në semestrin e dytë, në vitin e tretë, në 3 - 4 javë, pranë kompanive, institucioneve apo organizatave, aktiviteti i të cilave mbështetet në teknologjitë e lidhura me fushat përkatëse Inxhinierike. Me fitimin e krediteve të saj studenti duhet të jetë i aftë:

Të orjentohej drejt dhe në mënyrën e duhur në tregun e punës në kompanitë, institucionet, organizatat aktiviteti i të cilave lidhet apo mbështetet në teknologjitë e fushave përkatëse Inxhinierike.

Të njohë organizimin e kompanive, institucioneve apo organizatave. Të kuptojë rëndësinë e rregullave të sigurisë, rregullave të punës, detyrave dhe të drejtave që rrjedhin prej legjislacionit.

Të punojë në grup dhe në mënyrë të pavaruar; të respektojë rregullat e sjelljes dhe të etikës profesionale, të jetë i hapur ndaj diskutimeve profesionale, të ruajë sekretin profesional dhe informacionet konfidenciale të lidhura me sistemet apo proceset specifike; të kuptojë rëndësinë e inisiativave, detyrave dhe riskut që rrjedh prej zbatimit të tyre.

Të përdori dhe thellojë njohuritë e marra në shkollë, për përdorimin e tyre efikas në sistemet praktike të lidhura me sistemet elektronike, rrjetat e kompjuterave, rrjetat e telekomunikacioneve, protokollet e transmetimit të të dhënave, sistemet e kontrollit dhe sinjalizimit, shtresëzimin e sistemeve, protokollet e komunikimit, implementimin e rregullave/protokolleve të sigurisë së informacionit.

Të konceptojë: sistemet dhe proceset inxhinierike në tërësi, mënyrën e funksionimit të tyre; ndërthurjen e hardverit me softwaret përkatës; mënyrën e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve; nevojën për identifikimin e riskut dhe minimizimin e tij; llogaritjen e kostos së projektimit, implementimit, operimit dhe mirëmbajtjes.

Të identifikojë problemet, ti raportojë ato në mënyre profesionale; të konceptojë arsyet e ndodhjes së problemit dhe llogjikën teknike, analitike, profesionale të zgjidhjes së tyre.

### Vendet e mundshme për zhvillimin e praktikës

Studentët, mund të kryejnë praktikën pranë kompanive, institucioneve dhe organizatave, aktiviteti i të cilave mbështetet në teknologjitë e lidhura me fushat e Inxhinierisë Elektronike dhe Inxhinierisë së Telekomunikacionit.